



**PROGRAM ORIENTUES PËR NDËRTIMIN E FONDIT TË PYETJEVE PËR
PROVIMIN E RILICENCIMIT NË PSIKOLOGJI PËR PSIKOLOGËT QË
NUK KANË PLOTËSUAR KREDITET**

PËRBËRJA E KOMISIONIT:

Dr. Valbona Habilli

Dr. Lediana Xhakollari

Dr.Migena Buka

Dr.Ela Tollkuçi

Msc.Denisa Ndreka

Msc Naureda Bajraktari

Msc.Orsjola Miha

Msc.Erinda Bani

Tiranë, Prill 2023

© Urdhri i Psikologut në Republikën e Shqipërisë

Të gjitha të drejtat e rezervuara



I. HYRJE

Ky dokument është një program orientues mbi bazën e të cilit, do të hartohen pyetjet e provimit të rilicencimit për psikologët, të cilët nuk kanë plotësuar kreditet sipas Rregullores së Edukimit në Vazhdim e përditësuar me ndryshimet e fundit në Nëntor 2022. Programi është hartuar nga grupi i punës, i ngritur nga Urdhri i Psikologut në Republikën e Shqipërisë (UP), duke përmbushur, kurrikulën e zhvillimit të vazhdueshëm profesional të psikologut dhe përgatitjen për testimin e formimit profesional të kandidatit.

Programi është hartuar në përgjigje të kërkesave që Urdhri i Psikologut ka vendosur për kandidatët që do të testohen, duke përcaktuar njohuritë dhe aftësitë kryesore, sipas rubrikave të mëposhtme:

- Legjislacioni dhe akte ligjore në fuqi;
- Kodi i Etikës dhe Deontologjisë të Psikologëve në Republikën e Shqipërisë;
- Aspekte të veprimitarisë profesionale, praktikës së punës së psikologut sipas fushave të kompetencave, përkatësisht:
 - Fusha e kompetencës Shëndet Mendor;
 - Fusha e kompetencës Psikologji Edukimi;
 - Fusha e kompetencës Psikologji Pune dhe Organizacionale;
 - Fusha e kompetencës Psikologji Sociale dhe Komuniteti;
 - Fusha e kompetencës Psikologji Juridike;
- Si edhe zhvillimet e reja praktike dhe shkencore në fushat e mësipërme të kompetencës.





II. QËLLIMI I PROGRAMIT

Programi orientues për rilicencimin e psikologëve është hartuar për të mbështetur dhe nxitur zhvillimin profesional të psikologëve sipas fushave të kompetencës.

Programi synon:

- Rritjen e përgjegjshmërisë së psikologëve për njohjen dhe zbatimin e legjislacionit në fuqi sipas fushës së kompetencës;
- Rritjen e aftësive profesionale për të ofruar shërbim cilësor brenda fushës së kompetencës;
- Rritjen e përgjegjshmërisë së psikologëve për domosdoshmërinë e njohjes së detyrimeve ligjore dhe profesionale, si dhe të zbatimit të tyre në praktikë;
- Rritjen e përgjegjshmërisë së psikologëve për njohjen dhe zbatimin e rregullave të etikës dhe komunikimit në punën e tyre.

III. PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Programi orientues për rilicencimin e psikologut është strukturuar sipas fushave kryesore të zhvillimit profesional, të përmendura më sipër. Për secilën fushë, veç kompetencave profesionale, janë renditur edhe njohuritë dhe aftësitë bazë që duhet të zotërojë psikologu në ushtrimin e profesionit. Përshkallëzimi i njohurive dhe aftësive profesionale, të cilat lidhen me kompetencat e fushës përkatëse, ndihmojnë në identifikimin e nevojave dhe çështjet në të cilat duhet të përqendrohet kandidati. Programi është paraqitur për të qenë lehtësisht i përdorshëm.

Sipas këtij formati, për secilën fushë prezantohen kompetencat dhe rezultatet që priten të zotërojë psikologu si dhe literatura përkatëse rekomanduese që u vjen në ndihmë për zotërimin e këtyre kompetencave. Fondi i pyetjeve për testin e rilicencimit do të përbëhet ngapyetje dhe kërkesa të cilat japin mundësi të provohet shkalla e përvetësimit të njohurive dhe të shkathtësive për përdorimin e tyre. Testimi për provimin e rilicencimit do të jetë i organizuar me pyetje dhe kërkesa të cilat janë të kategorizuara në: identifikim dhe përshkrim, shpjegim dhe sintezë, si dhe vlerësim dhe problemzgjdhje.





IV. KATEGORIZIMI I PROGRAMIT SIPAS FUSHAVE TË KOMPETENCËS

A. FUSHA E KOMPETENCËS SHËNDET MENDOR

1) Legjislacioni dhe aktet ligjore në fuqi

Psikologët të cilët punojnë në fushën e Shëndetit Mendor duhet të kenë kompetenca në:

- Njohjen e kuadrit të përgjithshëm ligjor shqiptar për sa i përket shëndetit mendor (parimet e përgjithshme të kujdesit në shërbimet e shëndetit mendor, të drejtat e personave me çrregullime të shëndetit mendor, kategoritë e shërbimeve të shëndetit mendor etj.).
- Përshkrimin e rrjetit të shërbimeve të shëndetit mendor në Shqipëri, rolet dhe funksionet e tyre.
- Kuptimin e roleve, analizimi i përgjegjësive dhe shqyrtimi i kompetencave bazë të profesionistëve të shëndetit mendor.

Literatuara e rekomanduar

- Ligji Nr.44/2012 për shëndetin mendor;
- Rregullorja e shërbimeve të shëndetit mendor, Prill 2013;
- Rolet, përgjegjësitë dhe kompetencat bazë të profesionistëve të shëndetit mendor, Dhjetor 2013;

2) Kodi i Etikës dhe Deontologjisë i Urdhrit të Psikologut dhe Rregullorja e Gjykimit Disiplinor Profesional

- Njohja me parimet e përgjithshme të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë;
- Njohja me standardet etike që rregullojnë ofrimin e terapisë (aftësia për të ruajtur standarde profesionale dhe etike, vendosjen e kufijve të duhura me klientët dhe menaxhimin e konflikteve të interesit dhe dilemave etike që mund të dalin në praktikën klinike).

Literatuara e rekomanduar

- Urdhri i Psikologut (2017) Kodi i Etikës dhe Deontologjisë i Urdhrit të Psikologut në





Republikën e Shqipërisë.

E aksesueshme në: www.urdhriipsikologut.al;

- Urdhri i Psikologut (2017) Rregullorja e Gjykimit Disiplinor Profesional të Psikologut

E aksesueshme në:

<https://www.urdhriipsikologut.al/wp-content/uploads/2021/05/Rregullorja-e-Gjykimit-Disiplinor-Profesional-sic-eshte-pas-ndryshimeve-2020.docx>;

3) Aspekte të veprimtarisë profesionale, praktikës së punës së psikologut në fushën e kompetencës si edhe zhvillimet e reja praktike dhe shkencore në fushë.

- Njohja, analizimi dhe shpjegimi i metodave kryesore të vlerësimit të fëmijëve dhe të rriturve në fushën klinike (intervista klinike, vlerësimi i sjelljes, funksionimi konjitiv etj.);
- Njohja dhe klasifikimi i çrregullimeve të shëndetit mendor sipas DSM-V;
- Hartimi i planeve të trajtimit të çrregullimeve specifike (qëllime terapeutike, hapa, trajtimi dhe ndërhyrjet terapeutike sipas modaliteteve të ndryshme).

1	Çrregullimet e ankthit (Ankthi i Përgjithësuar, Çrregullimi i Panikut, Çrregullimi i Ankthit Social dhe Fobitë Specifike)
2	Çrregullimet Obsesive - Kompulsive
3	Çrregullimet e Humorit (Çrregullimi depresiv madhor & Çrregullimi bipolar).
4	Çrregullimet e personalitetit (Çrregullimi i personalitetit kufitar, Çrregullimi i personalitetit narcizist, Çrregullimi i personalitetit antisocial, Çrregullimi i personalitetit shmangës, Çrregullimi i personalitetit obsesiv kompulsiv, Çrregullimi i personalitetit të varur)
5	Çrregullimet e të ngrënit (Anoreksia nervore, Bulimia nervore).
6	Çrregullimet e përdorimit të substancave (Varësia nga alkooli & substancat).
7	Çrregullime të lidhura me traumën (Çrregullimi i stresit post-traumatik & Çrregullimi i stresit akut).
8	Skizofrenia dhe çrregullimet e tjera psikotike.





B. FUSHA E KOMPETENCËS PSIKOLOGJI EDUKIMI

1) Legjislacioni dhe aktet ligjore në fuqi

Psikologu i edukimit, si pjesë e institucionit arsimor duhet të zotërojë këto kompetenca të orjentuara drejt:

- Njohjes së ligjit për sistemin arsimor parauniversitar;
- Njohjes së legjislacionit, udhëzimet dhe rregulloret për punën e tij si psikolog edukimi në institucionet arsimore;
- Respektimit të të drejtave dhe lirive të nxënësit;
- Respektimit të detyrave dhe të drejtave brenda fushës së kompetencës në marrëdhënie me nxënësit, mësuesit dhe prindërit.

Literatuara e rekomanduar

- Ligji Nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i Azhornuar dhe Aktet Nënligjore në Zbatim të Tij.
E aksesueshme në:
<http://arsimiparauniversitar.gov.al/wp-content/uploads/2019/06/ligji-per-sistemin-arsimor-parauniversitar.pdf>;
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. (2020) Rregullore për Funkcionimin e Institucioneve Arsimore Parauniversitare në Republikën e Shqipërisë. Urdhër Nr.31 datë 28.01.2020. Rregullore për IAP.
E aksesueshme në: <https://www.ascap.edu.al/udher-nr-31-date-28-01-2020-rregullore-per-iap>;
- Ligji Nr.18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”.
https://www.drejtesia.gov.al/wpcontent/uploads/2017/11/04_Ligj_18_2017_23.02.2017_Për_të_drejtat_dhe_mbrojtjen_e_fëmijës.pdf;
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, ASCAP (2020). Vlerësimi i Jashtëm dhe i Brendshëm i Shkollës.
E aksesueshme në: <https://www.ascap.edu.al/wpcontent/uploads/2020/05/7-Mars-2020-Udhezuesi-i-vleresimit-te-jashtem-dhe-te-brendshem-1-1.pdf>;





- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Urdhër Nr. 344, datë 19.08.2013 “Për ngritjen e njësisë së shërbimit psiko-social.
- E aksesueshme në: <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/09/Urdher-nr.-150-dt.-3.4.2018-sherbimi-psiko-social.pdf>;
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. (2018). Urdhër nr. 150, datë 3.4.2018 “Për një ndryshim në Urdhrin nr.344, datë 19.08.2013 “Për ngritjen e njësisë së shërbimit psiko-social”.
- E aksesueshme në: <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/09/Urdher-nr.-150-dt.-3.4.2018-sherbimi-psiko-social.pdf>;
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Urdhër Nr. 593, datë 31.12.2019 “Për Disa Ndryshime në Urdhrin 344, datë 19.08.2013 “Për ngritjen e njësisë së shërbimitpsiko-social”, i ndryshuar.
- Udhëzim nr. 18, datë 21.04.2008, “Për funksionimin e shërbimit psikologjik shkollor në sistemin arsimor parauniversitar”.
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Urdhër nr. 344, datë 19.08.2013. “Për ngritjen e njësisë së shërbimit psiko-social”
- E aksesueshme në: <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/09/Urdher-nr.-150-dt.-3.4.2018-sherbimi-psiko-social.pdf>;
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (2018). Urdhër nr. 150, datë 3.4.2018 “Për një ndryshim në Urdhrin nr. 344, datë 19.08.2013 “Për ngritjen e njësisë së shërbimit psiko-social”
- E aksesueshme në: <https://arsimi.gov.al/wp-content/uploads/2018/09/Urdher-nr.-150-dt.-3.4.2018-sherbimi-psiko-social.pdf>;
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Urdhër Nr. 593, datë 31.12.2019 “Për Disa Ndryshime në Urdhrin 344, datë 19.08.2013 “Për ngritjen e njësisë së shërbimit psiko-social”, i ndryshuar.
- Standardet profesionale
- E aksesueshme në: <https://www.ascap.edu.al/standardet-e-pergjithshme-profesionale-te-sherbimit-psiko-social-shkollor/>;
- "Metodologjia e vlerësimit psiko-social të punonjësve arsimorë dhe të punonjësve të





tjerë në institucionet arsimore parauniversitare" u hartua nga Drejtoria e Kurrikulës dhe e Kualifikimit në Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS). (ASCAP dhe MAS, tetor 2022).

E aksesueshme në: <https://www.ascap.edu.al/metodologjia-e-vleresimit-psiko-social-te-punonjesve-arsimore-dhe-te-punonjesve-te-tjere-ne-institucionet-arsimore-parauniversitare/>;

- Këshilli i Ministrave. Vendim Nr. 578, datë 3.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes.

E aksesueshme në: <http://differentandequal.org/wp-content/uploads/2019/09/VKM-nr.-578-dt-3.10.2018.pdf>;

- Udhëzimi nr. 12, datë 16.6.2022, "Për ngritjen dhe funksionimin e komisionit për vlerësimin psiko-social të punonjësve arsimorë dhe të punonjësve të tjerë në institucionet arsimore parauniversitare".

Aksesueshme: <http://lezhe.arsimiparauniversitar.gov.al/wpcontent/uploads/sites/3/2022/07/Udhezim-nr.12.date16.6.2022.pdf>;

2) Kodi i Etikës dhe Deontologjisë i Urdhrit të Psikologut dhe Rregullorja e Gjykitimit Disiplinor Profesional të Psikologut

Psikologu i Edukimit gjatë praktikës së tij profesionale:

- Njeh dhe respekton kufijtë e kompetencës;
- Reflekton mbi praktikën profesionale;
- Dokumenton punën mbi nxënësit në mënyrë të përshtatshme;
- Komunikon me familjet e nxënësve në mënyrë periodike dhe menaxhon shqetësimet e tyre me profesionalizëm dhe respekt;
- Angazhohet për t’u zhvilluar profesionalisht në mënyrë të vazhdueshme;
- Modelon sjellje dhe mban qëndrim profesional në të gjitha ndërveprimet nxënës, mësues dhe prindër;
- Manifeston standarde të larta të etikës, ndershmërisë, integritetit dhe konfidencialitetit





gjatë ndërveprimeve me kolegët, nxënësit, prindërit, mësuesit dhe aktorë të tjerë.

2. Literatuara e rekomanduar

- Urdhri i Psikologut (2017) Kodi i Etikës dhe Deontologjisë i Psikologëve në Republikën e Shqipërisë.
E aksesueshme në: www.urdhriipsikologut.al;
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, ASCAP (2022). Parimet për etikën profesionale të shërbimit psiko-social shkollor
E aksesueshme në: <https://www.ascap.edu.al/parimet-per-etiken-profesionale-te-sherbimit-psiko-social-shkollor/>;
- Urdhri i Psikologut (2017) Rregullorja e Gjykimit Disiplinor Profesional të Psikologut
<https://www.urdhriipsikologut.al/wp-content/uploads/2021/05/Rregullorja-e-Gjykimit-Disiplinor-Profesional-sic-eshte-pas-ndryshimeve-2020.docx>;

3) Aspekte të veprimitarisë profesionale, praktikës së punës së psikologut në fushën e kompetencës si edhe zhvillimet e reja praktike dhe shkencore në fushë

Referuar aftësive praktike dhe profesionale psikologu i edukimit:

- Demonstron njohuri të teorive, praktikave më të mira dhe teknikave të përshtatshme për ofrimin e shërbimit psikologjik në shkollë;
- Demonstron njohuri të karakteristikave zhvillimore të nxënësve;
- Përzgjedh dhe planifikon veprimtari të përshtatshme me natyrë psikologjike për shkollën;
- Harton plane dhe/ose ndërhyrje psikologjike me qëllim adresimin e nevojave të ndryshme të nxënësve;
- Ndhmon në krijimin në e një mjedisi shkollor të dominuar nga respekti për njëri-tjetrin dhe nxit një kulturë të marrëdhënieve pozitive dhe kuptimplota midis të gjithë aktorëve në shkollë;
- Planifikon hapa të arsyeshëm për menaxhimin e sjelljeveproblematike të nxënësve;
- Krijon dhe nxit një mjedis shkollor që është i sigurt në aspektin fizik dhe emocional;





- Komunikon në mënyrë të qartë dhe të përshtatshme me nxënësit, prindërit, mësuesit dhe drejtuesin e shkollës;
- Ofron mbështetje për nxënësit, prindërit edhe mësuesit;
- Realizon vlerësime të nevojave edukative si edhe të funksionimit intelektual, akademik, social, emocional, etj. të nxënësit;
- Adreson shqetësimet e mësuesve ose prindërve në lidhje me probleme të ndryshme të nxënësve;
- Promovon sjelljen pozitive dhe shëndetin mendor;
- Mbështet dhe bashkëpunon me aktorët e tjerë të shkollës për të adresuar nevojat e nxënësve me aftësi të kufizuar në shkollë;
- Ndhmon familjet dhe shkollën të menaxhojnë situata krize;
- Promovon partneritetin familje-shkollë në bashkëpunim me aktorët e tjerë;
- Bën referime ose siguron akses në shërbime të tjera jashtë shkolle, që mund të jenë të nevojshme për nxënësit.

3.b Literatuara e rekomanduar

- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe TDH Albania (2020). Manuali i punës së shërbimit psiko-social në shkolla; https://childhub.org/sites/default/files/library/attachments/manuali_psiko_social_shkolla.pdf;
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Dhe ASCAP (2022) Udhëzuesi për praktikën e punës së shërbimit psiko-social shkollor
E aksesueshme në: <https://www.ascap.edu.al/udhezuesi-per-praktiken-e-punes-se-sherbimit-psiko-social-shkollor/>;
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, IZHA, UNICEF. (2019). “Ndërhyrjet për Sjelljet Pozitive në Shkollë si Mënyrë Për Parandalimin e Dhunë”
E aksesueshme në: https://www.unicef.org/albania/sites/unicef.org.albania/files/2019-02/%28PE%20BOTIM%29%20Manuali_Dhunes_UNICEF_final.pdf;
- Fakulteti i Shkencave Sociale, Departamenti i Psikologjisë. (2019). Udhëzuesi Për ndërhyrjen e parë psikologjike në kontekstin shkollor
E aksesueshme në: <https://fshs-ut.edu.al/?p=5651>





- Dokumenti “Programi kundër bullizmit në shkolla “Manual për punonjësit e shërbimit psikosocial” hartuar nga Drejtorja e Kurrikulës dhe e Kualifikimit në Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS). (ASCAP dhe MAS, qershor 2022)
E aksesueshme në: <https://www.ascap.edu.al/wp-content/uploads/2022/07/Programi-i-bullizmit.pdf>;
- World Vision. (2014). Jam mes jush i ndryshëm, i ngjashëm, i barabartë
Aksesueshme: <https://www.wvi.org/sites/default/files/Manuali%20Jam%20mes%20jush%20final.pdf>
- Dokumenti “Programi kundër bullizmit në shkolla “Manual për punonjësit e shërbimit psikosocial” hartuar nga Drejtorja e Kurrikulës dhe e Kualifikimit në Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit (MAS). (ASCAP dhe MAS, qershor 2022)
E aksesueshme në: <https://www.ascap.edu.al/programi-kunder-bullizmit-manual-per-punonjesit-e-sherbimit-psiko-social-ne-shkolle/>
- Ministria e Arsimit dhe Sportit (2016). Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë. Vendim i Këshillit të Këshilli i Ministrave. Vendimi Nr. 930, datë 18.11.2015. Për miratimin e strategjisë kombëtare për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe planit të veprimit.
Aksesueshme: https://mb.gov.al/wpcontent/uploads/2018/07/strategjia_kombetare_per_luften_kunder_ekstrmizmit.pdf





C. FUSHA E KOMPETENCËS PSIKOLOGJI PUNE DHE ORGANIZACIONALE

1) Legjislacioni dhe aktet ligjore në fuqi

Nëse kompetencat janë një kombinim i një seti njohurish, aftësish dhe qëndrimeve të përshtatshme në një kontekst të caktuar, atëherë psikologët e punës dhe organizacional duhet të kenë njohuri dhe aftësi, të kuptojnë, integrojnë dhe mbajnë qëndrimet e duhura bazuar te ligjet, statutet, rregulloret dhe precedentët ligjorë përkatës (p.sh. Kodi i Punës së Shqipërisë). Ata gjithashtu duhet të kenë njohuri për akomodimet e kërkuara nga Ligji për Personat me Aftësi të Kufizuara dhe të jenë të njohur me parimet universale. Meqenëse një sasi e mjaftueshme e punës profesionale të kryer në organizata mbulohet nga kontratat e punës të negociuara, kompetenca në këtë fushë do të përfshinte gjithashtu një ndërgjegjësim për mundësitë dhe kufizimet e vendosura nga marrëveshje të tilla, si dhe një vlerësim të dinamikës së punës/menaxhimit të lidhura me to.

1.a Literaturara e rekomanduar

- Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë / RSH. Kuvendi. - Tiranë: Qendra e Botimeve Zyrtare, 2016.
Aksesueshme: https://www.idp.al/wpcontent/uploads/2017/03/Kodi_i_Pun%C3%ABs_2016.pdf
- Ligji nr. 93/2014 për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara.
E aksesueshme në: <https://special.aipa.al/wp-content/uploads/2019/04/Ligj-nr-93-dt-24.7.2014-Per-perfshirjen-dhe-aksesueshmerine-e-personavae-me-aftesi-te-kufizuar-.pdf>

1.b Literaturara e rekomanduar plotësuese

- Ligji Nr.10433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji Nr.9634, datë 30.10.2006 “Për inspektimin e punës dhe inspektoratin shtetëror të punës”;
- Ligji Nr.10237, datë 18.02.2010 “Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë”;
- Ligji Nr.9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”;





- Ligji Nr.7995, datë 20.09.1995 “Për nxitjen e punësimit” i ndryshuar;
- Ligji Nr.9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji Nr.108/2013 “Për të huajt”, i ndryshuar;
- VKM Nr.513, datë 30.7.2004 “Për klasifikimin e veprimtarisë dhe për dokumentacionin e procedurën për dhënien e lejes nga inspektori i punës, para vënies në punë të ndërmarrjes”;
- VKM Nr. 788, datë 14.12.2005” Për përcaktimin e aksidentit në punë ose për shkak të punës”;
- VKM Nr. 658, datë 17.10.2005 “Për standardet e shërbimeve shoqërore”;
- VKM Nr. 659, datë 17.10.2005 “Për standardet e shërbimeve të përkujdesit shoqëror, për fëmijët në institucionet rezidenciale”;
- VKM Nr. 512, datë 31.5.2006 “Për procedurat e kryerjes së kontrollit të ndihmës ekonomike, të pagesës së aftësisë së kufizuar dhe shërbimeve shoqërore” i ndryshuar;
- VKM Nr. 658, datë 17.10.2005 “Për standardet e shërbimeve shoqërore”;
- VKM Nr 562 datë 03.07.2013, “Për miratimin e rregullores “Për Kërkesat Minimale të Sigurisë dhe Shëndetit në Përdorimin e Pajisjeve të Punës në Vendin e Punës”;
- VKM Nr.563 datë 03.07 2013, Për miratimin e rregullores “Për Kërkesat Minimale të Sigurisë dhe Shëndetit për Përdorimin e Pajisjeve Mbrojtëse Individuale në Vendin e Punës”;
- VKM Nr.564 datë 03.07.2013, Për miratimin e rregullores “Për Kërkesat Minimale të Sigurisë dhe Shëndetit në Vendin e Punës”;
- VKM Nr.108, datë 09.02.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe tëshëndetit në punë”;
- VKM Nr.107, datë 9.2.2011 “Për përbërjen, rregullat e organizimit dhe tëfungsionimit të Këshillit të Sigurisë dhe shëndetit në punë dhe përfaqësuesit të punëmarrësve”;
- VKM Nr.108, datë 09.02.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të





shëndetit në punë”, i ndryshuar.

2) Kodi i Etikës dhe Deontologjisë i Urdhrit të Psikologut dhe Rregullorja e Gjykimit Disiplinor Profesional të Psikologut

Kompetencat e psikologëve lidhen me shërbimet që ata u ofrojnë klientëve me qëllim promovimin e zhvillimit, mirëqenies dhe performancës së individëve, grupeve, organizatave dhe shoqërinë. Në këtë aspekt theks i duhet vënë etikës. Psikologu nuk duhet të dijë vetëm rregullat e etikës profesionale, por të jetë në gjendje t'i zbatojë ato në mënyrë efektive në praktikë. Kjo fushë ka të bëjë me kontekstet e ndryshme brenda të cilave operon psikologu i punës dhe organizacional. Këta psikologë fitojnë njohuri dhe respektojnë udhëzimet etike përkatëse kur këshillohen, si dhe japin mësim, kryejnë kërkime dhe këshillojnë. Nëse përgjegjësitë etike të psikologëve bien ndesh me ligjin, rregulloret ose ndonjë autoritet tjetër ligjor qeveritar, psikologët bëjnë të ditur angazhimin e tyre sipas Kodi Etik dhe marrin hapa dhe mbajnë qëndrime për të zgjidhur konfliktin në një mënyrë të arsyeshme, në përputhje me parimet themelore të të drejtave të njeriut.

Literatuara e rekomanduar

- Kodi i Etikës dhe Deontologjisë i Urdhrit të Psikologut

E aksesueshme në: <https://www.urdhripsikologut.al/wp-content/uploads/2019/10/Kodi-i-Eikes-dhe-Deontologjise-1-1.pdf>

- Rregullorja e Gjykimit Disiplinor Profesional të Psikologut

E aksesueshme në:

<https://www.urdhripsikologut.al/wpcontent/uploads/2022/09/Rregullorja-e-Gjykimit-Disiplinor-Profesional-pas-ndryshimeve-2023.pdf>

3) Aspekte të veprimitarisë profesionale, praktikës së punës së psikologut në fushën e kompetencës si edhe zhvillimet e reja praktike dhe shkencore në fushë

Kompetencat lidhur me këtë fushë janë parë në dy nivele:

- 1) Menaxhimi profesional/praktika profesionale (ku përfshihet vlerësimi i performancës së





punonjësve; vlerësimi i nevojave të tyre; vlerësimi i nevojave për trajnim; menaxhimit të burimeve njerëzore, rekrutimi, përzgjedhja, vendosja në pozicionin e përshtatshëm, orientimi në karrierë dhe zhvillimi i tregut).

2) Vetë-menaxhimi (i cili përfshin kërkimin dhe zhvillimin profesional të vazhdueshëm dhe vetë-reflektimin).

Psikologët që praktikojnë në fushën e punës dhe organizacionale duhet të jenë kompetentë në analizimin e qëllimeve të klientëve, bërjen e llojeve të duhura të vlerësimeve, zhvillimin e kërkuar, instrumentet, planifikimin dhe zbatimin e ndërhyrjeve të duhura, vlerësimin e efekteve, dhënien e reagimeve të përshtatshme për klientët, etj., të gjitha në kontekstin e punës dhe të organizatave.

3.1. Praktikë e vlerësimit të performancës së punonjësve dhe vlerësimi i nevojave të tyre për trajnim dhe zhvillim profesional

- Vlerësimi i nevojave i referohet një grupi njohurish, aftësish dhe qëndrimesh që nevojiten për vlerësimin, interpretimin dhe komunikimin e karakteristikave dalluese të individëve për një sërë qëllimesh të lidhura me punën. Dy qëllimet kryesore të vlerësimit individual mund të përkufizohen gjerësisht si **përzgjedhja** (p.sh. punësimi, promovimi, vendosja) dhe **zhvillimi** (p.sh. planifikimi i karrierës, ndërtimi i aftësive dhe kompetencave, rehabilitimi, këshillimi i punonjësve, trajnimi).
- Vlerësimi individual mund të ndihmojë në arritjen e qëllimeve të shumëfishta, shumë prej të cilave synojnë arritjen e një forme të përshtatjes së mjedisit të personit, duke përfshirë përshtatjen e të vlerësuarit për një punë specifike ose rrugën e karrierës dhe përshtatjen e të vlerësuarit brenda një konteksti organizativ specifik (p.sh. departamenti, grupi i punës).
- Vlerësimi individual përfshin aftësi në testimin individual, intervistimin dhe teknikat e vlerësimit, me qëllim vlerësimin e aftësive, personalitetit, aftësive dhe karakteristikave të interesit.
- Vlerësimi individual kërkon gjithashtu identifikimin, zhvillimin, përzgjedhjen dhe/ose përdorimin e mjeteve të përshtatshme për një vlerësim të tillë, duke marrë në konsideratë çdo dallim të rëndësishëm individual. Ai gjithashtu kërkon komunikimin





e rezultateve dhe interpretimin e saktë të vlerësimit në formë ballë për ballë dhe/ose me shkrim. Përveç kësaj, është e nevojshme njohja e mënyrës në të cilën faktorët mjedisorë dhe kontekstualë formojnë qëllimin dhe përdorimin e informacionit tëgrumbulluar të vlerësimeve individuale.

Vlerësimi/menaxhimi i performancës ka një bazë njohurish dhe aftësish. Kjo fushë (nganjëherë e referuar edhe si menaxhimi i talenteve) përqendrohet në metodat e matjes dhe vlerësimit të individëve gjatë kryerjes së detyrave organizative, ndikimin e kontekstit social në të cilin ata kryehen dhe vlerësohen, dhe në marrjen e veprimeve (administrative të tilla si promovimi/vazhdimësi ose shpërblime dhe/ose zhvillimi) bazuar në këto vlerësime. Baza e njohurive përfshin një kuptim të plotë të ndërtimit dhe përdorimit të shkallës së vlerësimit dhe trajnimit të vlerësuesve. Gjithashtu relevante janë fushat e teorisë psikometrike, zhvillimi i matjeve, analiza e të dhënave, teoria dhe zhvillimi i kriterëve, teoria e motivimit dhe faktorët që qëndrojnë në themel të perceptimit, gjykimit dhe vlerësimit ndërpersonal (d.m.th., vlerësimi). Është thelbësore të kuptuarit e ngjashmërive, dallimeve dhe mospërputhjeve midis perceptimeve dhe vlerësimeve të performancës dhe reagimeve të ofruara nga kolegët, klientët, vartësit dhe mbikëqyrësit.

Gjithashtu, kërkohet aftësi në hartimin e një sistemi të plotë të vlerësimit të performancës së menaxhimit dhe reflektimit që plotëson nevojat organizative, duke ruajtur dhe/ ose rritur motivimin dhe/ose performancën e punonjësve.

3.2. Psikologjia në praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore (rekrutimi, përzgjedhja, vendosja në pozicionin e përshtatshëm, etj.)

Menaxhimi i burimeve njerëzore përbëhet nga teoria dhe teknikat e përfshira në përputhjen efektive të nevojave, preferencave, aftësive dhe aftësive të rekrutëve për punë, aplikantëve për punë dhe punonjësve ekzistues, me nevojat dhe preferencat e organizatave. Nevojat e një organizate në këtë kontekst përcaktohen nga punët e caktuara në pozicionet në organizatë. Kjo fushë përfshin teorinë dhe kërkimin në: aftësitë njerëzore; teorinë e testimit, zhvillimin dhe përmirësimin; analizën e punës; zhvillimin dhe matjet e kriterit; rekrutimin; modelet klasike dhe të teorisë të përzgjedhjes dhe vendosjes së një punonjësi në pozicionin e përshtatshëm; strategji të ndryshme rekrutimi; pajisjet alternative të përzgjedhjes (p.sh.,





intervistat, qendrat e vlerësimit). Në veçanti, individi duhet të jetë i informuar me legjislacionin dhe vendimet gjyqësore në lidhje me diskriminimin në lidhje me punësimin.

3.3. Orientimi në karrierë dhe zhvillimi i tregut të punës

Teoria dhe kërkimi në lidhje me zhvillimin e karrierës kanë të bëjnë me ndërveprimin midis individëve dhe mjediseve të tyre sociale dhe kulturore dhe përpiqen të përshkruajnë natyrën e modeleve të pozicioneve të mbajtura dhe përvojave gjatë jetëgjatësisë së një individi. Të përfshira në këtë fushë janë modele dhe shpjegime të origjinës dhe matjes së aftësive individuale dhe interesave profesionale; si faktorët individualë, socialë, mjedisorë dhe të rastësishëm i formësojnë përvojat arsimore dhe trajnuese; trajnimi dhe zhvillimi i aftësive specifike; historia e hershme e punës; zgjedhja e profesionit; zgjedhja dhe ndërrimi organizativ; sekuenca e punëve të marra pas hyrjes në organizatë; çështjet e punës/familjes; dhe planifikimin e daljes në pension.

3.4. Metodat e kërkimit shkencor në fushën e psikologjisë organizacionale

Psikologët e punës dhe organizacionale aplikojnë metodat e kërkimit për të studiuar çështje me rëndësi kritike për individët, bizneset dhe shoqërinë. Fusha e metodave të kërkimit përfshin procedurat, teknikat dhe mjetet e dobishme në kryerjen e hetimeve empirike të fenomeneve me interes në psikologjinë e punës dhe organizacionale. Fushat specifike të përfshira nga metodat e kërkimit përfshijnë metodën shkencore (me vëmendje ndaj çështjeve në filozofinë e shkencës); arsyetimin induktiv dhe deduktiv, gjenerimin dhe artikullimin e deklaratave të problemit, pyetjeve kërkimore dhe hipotezave; rishikimin dhe kritikën e literaturës; natyrën dhe përkufizimin e konstrukteve; dizajne studimore (eksperimentale, kuazi-eksperimentale dhe joeksperimentale); dhe psikometrike.

Në një nivel operacional, metodat e kërkimit përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në, manipulimin e variablave (në kërkimin eksperimental), konceptet në themel dhe metodat e përdorura për vlerësimin e besueshmërisë dhe vlefshmërisë së masave, administrimin e masave të ndryshme (pyetësorë, intervistat, vëzhgimet e sjelljes, masat projektuese, etj.), përdorimi i procedurave të ndryshme të marrjes së mostrave (të bazuara në probabilitet dhe joprobabilitet) veçanërisht të aplikuara për kërkimin në anketë, kryerjen e kërkimeve në laborator dhe në terren me strategji të ndryshme (eksperiment, anketë, simulim, studim rasti,





etj.), përdorimi i metodave statistikore për të vendosur marrëdhëniet midis variablave, shkakësisë dhe formulimi i përfundimeve të bazuara në kërkime. Gjithashtu metodat e kërkimit shkencor përfshijnë edhe përdorimin e teknikave e ndryshme statistikore që përdoren në analizën e të dhënave të gjeneruara nga kërkimet empirike. Fusha përfshin metoda statistikore përshkruese dhe konkluduese, përfshin metoda statistikore parametrike dhe joparametrike dhe përfshin metoda kërkimore dhe analiza të të dhënave si sasiore ashtu edhe cilësore. Ndër temat specifike të përfshira në këtë fushë janë: vlerësimet e tendencës qendrore, vlerësimet e ndryshueshmërisë, shpërndarjet e mostrave, vlerësimet e pikës dhe intervalit, konkluzionet rreth ndryshimeve midis mesatareve dhe proporcioneve, analizat univariate dhe multivariate të variancës (modele me efekte fikse, të rastësishme dhe të përziera), dhe regresioni dhe korrelacioni linear dhe jolinear.

Literatuara e rekomanduar

- Manual praktik për zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil dhe menaxhimit të burimeve njerëzore.

E aksesueshme në: <https://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/446-manual-praktik-mbi-zbatimin-e-legjislacionit-te-sherbimit-civil-dhe-menaxhimit-te-burimeve-njerezore>





D. PSIKOLOGJI SOCIALE DHE KOMUNITETI

1) Legjislacioni dhe aktet ligjore në fuqi

Psikologjia Sociale dhe e Komunitetit është një fushë aplikimi dhe studimi në Psikologji që ka në fokus individët brenda marrëdhënieve, komuniteteve dhe shoqërisë në përgjithësi. Në vendin tonë, kjo fushë i referohet kryesisht psikologëve që operojnë në grupe ndërdisiplinore apo rrjete të koordinuara të punës. Roli i këtij psikologu, bëhet i rëndësishëm sot për të gjitha ato sfera sociale dhe të shëndetit mendor ku punohet në ekipe multidisiplinore. Më konkretisht, nisur nga tërësia e ligjeve, udhëzimeve, urdhëresave dhe dokumentave në fuqi në vendin tonë, tre janë fushat kryesore ku punon sot një psikolog me profil Psikologji Sociale dhe Komuniteti:

- shërbimet komunitare të shëndetit mendor (referoju Ligjit për Shëndetin Mendor, më konkretisht, Nenit 13 për Shërbimet Komunitare të Shëndetit Mendor dhe Nenit 18 për Shëndetin Mendor në institucionet rezidenciale të përkujdesit social);
- njësitë dhe grupet teknike për mbrojtjen e fëmijëve;
- rrjeti i institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen nga dhuna në familje, dhuna seksuale dhe trafikimi i qënieve njerëzore. Prej vitit 2013, objektivat madhorë të lidhur me shëndetin mendor në vendin tonë, janë decentralizimi i shërbimit të shëndetit mendor dhe deinstitutionalizimi nëpërmjet fuqizimit të shërbimeve komunitare të shëndetit mendor (referoju planit për zhvillimin e shërbimeve për shëndetin mendor 2013-2022).

Shërbimi shëndetësor në bazë komuniteti përbëhet nga:

- Qëndrat komunitare të shëndetit mendor;
- Ekipet multidisiplinore lëvizëse;
- Shtëpitë e mbështetura për ish pacientët kronikë në spitalet psikiatrike;
- Shtëpitë e mbështetura për pacientët psikiatrikë;
- Qendrat e rekreacionit;

Psikologu me profil Psikologji Sociale dhe Komuniteti sot luan një rol të rëndësishëm në aktivitetet e rehabilitimit psiko-social në Qendrat komunitare të shëndetit mendor (QKSHM).

Në kuadër të punës për mbrojtjen e fëmijëve, psikologu me profil Psikologji Sociale dhe





Komuniteti mund të ofrojë shërbim në Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve që operojnë në nivel vendor brenda bashkive, si pjesë e Grupeve Teknike Ndërsektorial ad-hoc (GTN) ku si i tillë, mund të jetë edhe në rolin e përfaqësuesit nga organizatat jofitimprurëse dhe shoqëria civile. Në zbatimin të Ligjit Nr. 10 347 datë 04.11.2010 “Për mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve“, Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve është organi përgjegjës që ka për mision të monitorojë dhe të garantojë bashkëpunim me autoritetet e tjera shtetërore dhe organizatat jofitimprurëse, për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe përkujdesjen e posaçme ndaj tyre.

Psikologu me profil Psikologji Sociale dhe Komuniteti është gjithashtu pjesë e institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen, për mekanizmat e koordinuar të referimit me qëllim mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës në familje, dhunës seksuale dhe trafikimit të qënieve njerëzore. Në këtë kuadër ai funksionon brenda një rrjeti të organizuar institucionesh përgjegjëse në nivel vendor për parandalimin, mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të dhunës dhe trafikimit. Ai mund të shërbejë në funksionin e koordinatorit vendor pranë bashkive, përfaqësues i organizatave jo fitimprurëse, përfaqësues i qendrave dhe strehëzave të ngritura për viktimat e dhunës dhe të trafikimit. Në këtë funksion, ai është gjithashtu anëtar i ekipeve teknike ndërdisiplinore (ETN) që ndjekin dhe menaxhojnë rastet, koordinojnë dhe mbikëqyrin shërbimet, referojnë, raportojnë dhe monitorojnë mbi dhunën në familje. Për funksione më specifike, sikurse është rasti i Ekipit Bërthamë të ETN-së, të gjitha këto shërbime lidhen me trajtimin specifik të viktimave të sulmeve seksuale. Parimet e funksionimit të këtyre grupeve kanë një qasje me në qendër viktimën duke garantuar njohje të mirë të menaxhimit të rastit dhe garantimit të mbrojtjes nëpërmjet Urdhrave të mbrojtjes.

Literatuara e rekomanduar

- Ligji nr. 44/2012 Për Shëndetin Mendor.

I aksesueshëm në:

https://shendetesia.gov.al/wpcontent/uploads/2018/03/Ligji_Nr.44_2012_per_shendetin_mendor.pdf

Paketa e Akteve Nënligjore të Mbështetura në Ligjin Nr. 44/2012 “Për Shëndetin mendor“

I aksesueshëm në:





https://www.osfa.al/sites/default/files/paketa_e_akteve_nen_ligjore_per_shendetin_mendor_2012.pdf

- Rregullorja e Shërbimeve të Shëndetit Mendor, prill 2013.

E aksesueshme në: [https://shendetesia.gov.al/wp-](https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/03/Rregullorja_e_Sherbimeve_te_Shendetit_Mendor_prill_2013.pdf)

[content/uploads/2018/03/Rregullorja_e_Sherbimeve_te_Shendetit_Mendor_prill_2013.pdf](https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/03/Rregullorja_e_Sherbimeve_te_Shendetit_Mendor_prill_2013.pdf)

- Ligji nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës“.

I aksesueshëm në:

https://www.drejtesia.gov.al/wpcontent/uploads/2017/11/04_Ligj_18_2017_23.02.2017_Për_të_drejtat_dhe_mbrojtjen_e_fëmijës.pdf

- Rregullore “Për Organizimin dhe Funkzionimin e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës.

E aksesueshme në: [https://www.observator.org.al/wp-content/uploads/2015/09/VKM-Nr.-](https://www.observator.org.al/wp-content/uploads/2015/09/VKM-Nr.-346-Dt-29.04.2011-p%C3%ABr-Miratimin-e-Rregullores-p%C3%ABr-Organizimin-dhe-Funksionimin-e-Agjencis%C3%AB-Shtet%C3%ABrore-p%C3%ABr-Mbrojtjen-e-t%C3%AB-Drejtave-t%C3%AB-F%C3%ABmij%C3%ABs.pdf)

[346-Dt-29.04.2011-p%C3%ABr-Miratimin-e-Rregullores-p%C3%ABr-Organizimin-dhe-Funksionimin-e-Agjencis%C3%AB-Shtet%C3%ABrore-p%C3%ABr-Mbrojtjen-e-t%C3%AB-Drejtave-t%C3%AB-F%C3%ABmij%C3%ABs.pdf](https://www.observator.org.al/wp-content/uploads/2015/09/VKM-Nr.-346-Dt-29.04.2011-p%C3%ABr-Miratimin-e-Rregullores-p%C3%ABr-Organizimin-dhe-Funksionimin-e-Agjencis%C3%AB-Shtet%C3%ABrore-p%C3%ABr-Mbrojtjen-e-t%C3%AB-Drejtave-t%C3%AB-F%C3%ABmij%C3%ABs.pdf)

- Udhëzim Nr. 10, datë 25.2.2015. Për Mënyrat, Format e Bashkëpunimit dhe Procedurat e Ndërhyrjes në Ndihmë të Fëmijëve në Rrezik për Institucionet dhe Strukturat Kryesore Përgjegjëse për Mbrojtjen e Fëmijës.

I aksesueshëm në:

http://www.sherbimisocial.gov.al/wpcontent/uploads/2014/03/Udh%C3%ABzim_10_25.02.2015.pdf

- Këshilli i Ministrave. Vendimi Nr. 353, datë 12.6.2018. Për rregullat e funksionimit të grupit teknik, ndërsektorial Për mbrojtjen e fëmijëve, pranë bashkive dhe njësive Administrative.

I aksesueshëm në: <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2018/06/12/353/c316c4f2-e10a-4a8d-a105-a561b75beb32;q=grupi%20teknik%20ndersektorial>

- Këshilli i Ministrave. Vendim Nr. 578, datë 3.10.2018. “Për Procedurat e Referimit e të Menaxhimit të Rastit, Hartimin dhe Përmbytjen e Planit Individual të Mbrojtjes, Financimin e Shpenzimeve për Zbatimin e tij, si dhe Zbatimin e Masave të mbrojtjes“.

I aksesueshëm në: <http://differentandequal.org/ep-content/uploads/2019/09/VKM-nr.-578-dt-3.10.2018.pdf>





- Ligji Nr. 9669/2018 Për Masa ndaj Dhunës në Marrëdhëniet Familjare.

I aksesueshëm në: <https://shendetesia.gov.al/ligje-7/>

- Ligji Nr. 125/2020 “ Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 9669, dt.18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” , i ndryshuar.

I aksesueshëm në: <https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/07/Ligj-Nr.125-2020-Shtesa-dhe-ndryshime-te-LDHF-6996-2016.pdf>

- Udhëzim Nr. 3799, datë 8.7.2014 për Ngritjen e Autoritetit Përgjegjës për Identifikimin, Referimin, Mbrojtjen dhe Riintegrimin e Viktimave/Viktimave të Mundshme të Trafikimit.

I aksesueshëm në: <https://mb.gov.al/wp-content/uploads/2019/12/UDHEZIMI-AP.pdf>

2) Kodi i Etikës dhe Deontologjisë i Urdhrit të Psikologut dhe Rregullorja e Gjykitimit Disiplinor Profesional të Psikologut

Psikologu me profil Psikologji Sociale dhe Komuniteti gjatë punës së tij njeh dhe i referohet në çdo kohë, të gjitha pikave të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë të Urdhrit të Psikologut dhe Rregullores përkatëse. Në veçanti, ai/ajo duhet të ketë krijuar kompetenca në: hartimin e programeve të edukimit dhe trajnimit si edhe në përshkrimin e saktë të përmbajtjes së tyre; në terapinë individuale ose në grup; në marrjen e miratimit të informuar, kryesisht gjatë rasteve për të cilat punohet me teste. Njëkohësisht, nuk duhet të harrojmë që këto teste, kanë nevojë të ndërtohen, interpretohen, të shpjegohen rezultatet si edhe të ruhen sipas kriterëve të përcaktuara në kod; në marrjen e miratimit të informuar në terapi; në çështjet e lidhura me etikën për terapitë në familje apo ato në grup; në ofrimin e terapive për persona që marrin shërbim nga të tretë; në intimitetin seksual me klientin apo me të afërmit e rëndësishëm për të; në intimitetin seksual me ish klientët.

Gjithashtu, psikologu me këtë profil, duhet të jetë i njohur me Rregulloren e Gjykitimit Disiplinor Profesional të Psikologut dhe sidomos me Nenin 12 të kësaj Rregulloreje që i referohet masave disiplinore për shkeljen e Kodit të Etikës dhe Deontologjisë.

Literatuara e rekomanduara





- Kodi i Etikës dhe Deontologjisë i Urdhrit të Psikologut (2017).

I aksesueshëm në: <https://www.urdhriipsikologut.al/wp-content/uploads/2019/10/Kodi-i-Eikes-dhe-Deontologjise-1.pdf>

- Rregullorja e Gjykimit Disiplinor Profesional të Psikologut (me ndryshime 2020).

E aksesueshme në: <https://www.urdhriipsikologut.al/wp-content/uploads/2022/09/Rregullorja-e-Gjykimit-Disiplinor-Profesional-pas-ndryshimeve-2023.pdf>

3) Aspekte të veprimitarisë profesionale, praktikës së punës së psikologut në fushën e kompetencës si edhe zhvillimet e reja praktike dhe shkencore në fushë.

Psikologu me profil Psikologji Sociale dhe Komuniteti, që i atashohet shërbimeve komunitare të shëndetit mendor, ushtron kompetencat e tij/saj në atë që sot njihet si terapisti okupacional. Kjo terapi nuk lidhet vetëm me aftësimin në punë të klientit por dhe më së shumti, me rritjen e aftësive përshtatëse me mjedisin dhe me forcimin e kapaciteteve në përballjen me përditshmërinë. Për të realizuar këtë funksion, ky psikolog mund të punojë me individin në grup, sidomos kur qëllimi është rritja e ndërveprimit social. Gjithashtu ai mund edhe të punojë nëpërmjet terapive të ndryshme sikurse janë: CDT, terapitë e artit dhe të muzikës, teknikat e relaksimi, etj. Gjithashtu, këtij profesionisti i kërkohen kompetenca jo vetëm mbi shëndetin mendor por edhe aftësi vlerësuese, planifikuese, komunikuese, vendimmarrëse, parandaluese dhe të kodit të etikës profesionale.

Në kuadrin e punës për mbrojtjen e fëmijëve, qëllimi i ngritjes së grupeve teknikë është menaxhimi i rasteve në nevojë, çështjet e parandalimit dhe trajtimit të rasteve të neglizhimit të fëmijëve me qëllim minimizimin e dëmit si edhe ngritja e partneritetit më familjen. Psikologu me këtë profil, i vendosur në pozicionin e punonjësit të Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijës në nivel vendor, pasi ka identifikuar rastin, organizon punën duke thirrur mbledhjen e Grupit Teknik për menaxhimin e rastit dhe përgatitjen e projektplanit individual për mbrojtjen e fëmijës. Psikologu me profil Psikologji Sociale dhe Komunitetit që është pjesë e institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen, trajtimin dhe rehabilitim e viktimave të dhunës dhe trafikimit, duhet të ofrojë kujdes dhe mbështetje të mirë për viktimat, duke siguruar ndjekjen e rastit,





dhënien e informacionit, shpjegimet e statusit të çështjes, adresimin e nevojave afatmesme e afatgjata të identifikuara të lidhura me shëndetin, edukimin, punësimin, strehimin afatgjatë, etj. Në rastin e dhunës në familje dhe dhunës seksuale, menaxhimi i rasteve përmes qasjes shumë-sektoriale të koordinuar është domosdoshmëri. Menaxhimi i rastit të dhunës është një proces që mund të ndahet në hapa, secila me detyra të përcaktuara qartë. Dhuna kalon përmes disa etapave, indentifikimit të saj, vlerësimit të riskut dhe nevojve psiko-emocionale, vlerësimit të situatës familjare, vlerësimit të nevojve për akomodim, informim dhe vlerësimit për mbrojtje e siguri si edhe për formim profesional. Këto vlerësime ndiqen nëpërmjet planifikimit dhe zbatimit të ndihmës. Nuk duhet të harrojmë që e rëndësishme gjithashtu është edhe ndjekja e rastit në vazhdimësi. Në të gjitha këto aspekte, psikologu duhet të jetë nëgjendje të menaxhojë rrezikun si edhe të diferencojë rastet e emergjencës nga ato jo emergjente, me qëllim trajtimin specifik të tyre.

Literatuara e rekomanduara

- Plani i Veperimit për Zhvillimin e Shërbimeve të Shëndetit Mendor 2013 – 2022.

I aksesueshën në:

https://shendetesia.gov.al/wpcontent/uploads/2018/03/Plani_i_Vperimit_per_Zhvillimin_e_Sherbimeve_te_Shendetit_Mendor_2013_-_2022.pdf

- Rolet e profesionistëve të shërbimeve të shëndetit mendor (UMSH nr.693,dt.24.12.2013).

I aksesueshëm në:

https://shendetesia.gov.al/wpcontent/uploads/2018/03/Rolet_e_profesionistev_e_te_sherbimeve_e_te_shendetit_mendor_UMSH_nr.693dt.24.12.2013.pdf

- Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021 – 2026.

E aksesueshme në: https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/03/AKDF-2021-2026_ALB_FINAL-WEB.pdf

- Protokoll i Menaxhimit të Rasteve nga MKR.

I aksesueshëm në: <https://shendetesia.gov.al/vkm-4/>

- Protokoll i menaxhimit të rasteve të dhunës seksuale.

I aksesueshëm në: <https://shendetesia.gov.al/vkm-4/>





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
URDHRI I PSIKOLOGUT



- Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtjen e Viktimave dhe Viktimave të mundshme të Trafikimit.

I aksesueshëm në: <https://www.mb.gov.al/wp-content/uploads/2019/12/PROCEDURAT-STANDARDE-T%C3%8B-VEPRIMIT-PER-MBROJTJEN-E-VIKTIMAVE-TE-TRAFIKIMIT.pdf>

- Manual Operativ për Punonjës të Pushtetit Vendor që Vënë në Lëvizje Mekanizmat Kundër Trafikimit dhe Dhunës ndaj Grave.

I aksesueshëm në: <https://www.cies.it/wp-content/uploads/2018/07/Manuale-Operativo-ALB.pdf>





E. FUSHA E KOMPETENCËS PSIKOLOGJI JURIDIKE

1) Legjislacioni dhe aktet ligjore në fuqi

Psikologët juridikë dhe ligjorë duhet të kenë njohuri ligjore për të qenë të suksesshëm, pasi ndihmojnë agjensitë ligjzbatuese gjatë zbatimit të procedurave të ndryshme dhe po ashtu në vendimmarrje. Përditësimi që përfshin edhe njohuri për legjislacionin është shumë i dobishëm, e po ashtu njohja dhe të kuptuarit të procedurave të ndryshme ligjore. Prandaj, është e domosdoshme që psikologët e kësaj fushe kompetence të jenë të vetëdijshëm për ligjet që zbatohen në juridiksionet në të cilat ata synojnë të ushtrojnë; (Shuman, Cunningham, Connell, & Reid, 2003). Në këtë kuadër, ky program ka përfshirë vlerësimin e disa njohurive mbi legjislacionin duke iu referuar kryesisht ligjeve e akteve nënligjore të viteve të fundit, të cilat kanë ridimensionuar dhe fuqizuar rolin e psikologut në fushën e psikologjisë juridike.

Literatuara e rekomanduar

- LIGJ, Nr.9062, datë 8.5.2003, KODI I FAMILJES, (ndryshuar me ligjin nr. 134/2015, datë 5.12.2015) LIGJ Nr. 37/2017, KODI I DREJTËSISË PENALE PËR TË MITUR;
- LIGJ Nr. 18/2017 PËR TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËS
- VENDIM, Nr. 149, datë 13.3.2018 Për kriteret, dokumentacionin dhe procedurat për evidentimin e familjes kujdestare për fëmijët pa kujdes prindëror dhe masës së financimit për shpenzimet e fëmijës së vendosur në familje kujdestare
- VKM 207 e datës 10.04.2019 Për përcaktimin e autoriteteve kompetente dhe të procedurës që do të ndiqet për përmbushjen e detyrimeve të caktuara nga gjykata për të miturit në konflikt me ligjin;
- VENDIM, Nr. 578, datë 3.10.2018, Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes.
- UDHËZIM, Nr. 262, datë 26.5.2021, Për miratimin e metodologjisë së punës për menaxhimin e rastit të fëmijës në konflikt me ligjin, nga punonjësi i mbrojtjes së fëmijës.
- VENDIM, Nr. 327, datë 2.6.2021, Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse, për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet





familjare, si dhe procedimin e tij, për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës.

2) Kodi i Etikës dhe Deontologjisë i Urdhrit të Psikologut dhe Rregullorja e Gjykimit Disiplinor Profesional të Psikologut

Kur punojnë si psikologë juridikë dhe ligjorë, si në të gjitha fushat e punës profesionale, psikologët pritet të përputhen në sjelljen e tyre me Kodin e Etikës dhe Deontologjisë të Psikologëve në Republikën e Shqipërisë dhe Rregulloren e Gjykimit Disiplinor e Profesional të Psikologut.

Literatuara e rekomanduar

- Kodi i Etikës dhe Deontologjisë i Urdhrit të Psikologut (2017).

I aksesueshëm në: <https://www.urdhriipsikologut.al/wp-content/uploads/2019/10/Kodi-i-Eikes-dhe-Deontologjise-1.pdf>

- Rregullorja e Gjykimit Disiplinor Profesional të Psikologut (me ndryshime 2020).

E aksesueshme në: <https://www.urdhriipsikologut.al/wp-content/uploads/2022/09/Rregullorja-e-Gjykimit-Disiplinor-Profesional-pas-ndryshimeve-2023.pdf>

3) Aspekte të veprimtarisë profesionale, praktikës së punës së psikologut në fushën e kompetencës psikologji juridike si edhe zhvillimet e reja praktike dhe shkencore në fushë.

Fusha e psikologjisë juridike dhe ligjore ka patur rritje të jashtëzakonshme që prej vitit 2003 e në vazhdim në Shqipëri, kryesisht në fushën e legjislacionit vendas, i cili ka parashikuar rolin e psikologut ligjor në cilësinë e ekspertit në një seri procedurash, që lidhen kryesisht me vendimmarrjen për të miturit. Po ashtu, me krijimin e Urdhrit të Psikologut dhe bashkëpunimit me Ministrinë e Drejtësisë, u bë i mundur formalizimi i këtij nënspecialiteti ofrimin e një programi intensiv e gjithëpërfshirës trajnimi, që u pasua nga krijimi i listave të ekspertëve në fushën e drejtësisë. Megjithatë, ende shumë ka për të bërë sidomos në





aspektin e zhvillimit të programeve të edukimit në vazhdim, si dhe hartimit të dokumentave (*manuale e protokolle pune*) të cilat janë në mungesë, si dhe zhvillimit të metodologjisë së punës në përshtatje dhe të standardizuar për kontekstin vendas. Mungesa e këtyre dokumentave e bën më të vështirë përdorimin e referencave në gjuhën shqipe për hartimin e këtij programi. Kompetenca e psikologut juridikë dhe ligjor në fushën e vlerësimit karakterizohet nga detyrimi për të përdorur vlerësime që janë gjithëpërfshirëse, të besueshme dhe të vlefshme.

Për të përmbushur këtë kompetencë, psikologët duhet të kryejnë vlerësime të tilla, duke përfshirë njohuritë rreth praktikës gjyqësore dhe duke u ndërgjegjësuar për kufizimet në kryerjen e vlerësimeve. Në procesin e hartimit të pyetjeve në vijim të këtij programi, është marrë në konsideratë fakti se roli i psikologut juridik dhe ligjor në Shqipëri është parashikuar si në çështjet civile ashtu edhe ato penale, në cilësinë e ekspertit dhe asistuesit. Gjithashtu, ai është parashikuar dhe funksionon si pjesë e administratës në disa institucione të tjera, si pjesë e shërbimit në burgje, në qendra rehabilitimi, në shërbimin e provës, në polici etj., ku në varësi të target grupit të klientëve përfitues, ofron programe të ndryshme trajtimi.

Pyetjet e kësaj kategorie do të kenë të kenë fokus aspektet më thelbësore të veprimtarisë profesionale që psikologu juridik dhe ligjor kryen gjatë ushtrimit të këtij roli, duke përfshirë metodat që përdor psikologu në kryerjen e vlerësimeve, llojet e çështjeve në të cilat eksperti thirret, çështjet e analizuar, seksionet e raportit të vlerësimit, një pjesë e të cilave do të jenë pyetje të hapura, përfshirë kazuse, përgjigja e të cilave do të jepet përmes një shtjellimi narrativ. Pyetjet e kësaj kategorie do të përbëjnë 45% të numrit total të pyetjeve.

Literatuara e rekomanduar

- Manual mbi zbatimin e kodit të familjes dhe legjislacionit civil në lidhje me çështjet për të miturit. I aksesueshëm në:
[file:///C:/Users/CRS/Downloads/Manuali%20mbi%20zbatimin%20e%20Kodit%20\(1\).pdf](file:///C:/Users/CRS/Downloads/Manuali%20mbi%20zbatimin%20e%20Kodit%20(1).pdf)
- Fletëpalosjet e UNICEF për çështjet e shpërblimeve të dëmit. Të aksesueshme në:
<file:///C:/Users/CRS/Downloads/Flet%3%ABpalosje%20p%3%ABr%20GJYQTA%20RET%20n%3%AB%20procesin%20penal%20ME%20T%3%8B%20MITURIT%20>





[20\(1\).pdf](#)

[file:///C:/Users/CRS/Downloads/Flet%C3%ABpalosje%20p%C3%ABr%20gjyqtar%C3%ABt%20e%20SEKSIONEVE%20FAMILIARE%20\(1\).pdf](file:///C:/Users/CRS/Downloads/Flet%C3%ABpalosje%20p%C3%ABr%20gjyqtar%C3%ABt%20e%20SEKSIONEVE%20FAMILIARE%20(1).pdf)

[file:///C:/Users/CRS/Downloads/Flet%C3%ABpalosje%20p%C3%ABr%20GJYQTA RET%20n%C3%AB%20procesin%20penal%20ME%20T%C3%8B%20MITURIT%20\(3\).pdf](file:///C:/Users/CRS/Downloads/Flet%C3%ABpalosje%20p%C3%ABr%20GJYQTA RET%20n%C3%AB%20procesin%20penal%20ME%20T%C3%8B%20MITURIT%20(3).pdf)

- Psikologu dhe punonjësi social në drejtësinë për të miturit (në këtë manual nuk duhet të referohemi tek hyrja dhe tek aneksi V për shkak të ndryshimit të bazës ligjore);
[file:///C:/Users/CRS/Downloads/Manuali-i-psikologut-ne-Gjykate%20\(1\).pdf](file:///C:/Users/CRS/Downloads/Manuali-i-psikologut-ne-Gjykate%20(1).pdf)
- Udhëzues Roli i Psikologut në Polici

